



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:196570

Datë: 19.11.2024

Numri i dokumentit: 06473815

C.nr. 617/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.H nga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokate A.H nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar, vlera e objektit të kontestit 210.50 euro, jashtë seancës, më datën 19.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.H nga Rahoveci.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses F.H, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës t’ia paguajë 50% të pagës bazë (paga bazë 421.00 x 50% euro) në shumë prej 210.50 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 26.06.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses F.H, t’i paguajë shumën prej 99,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja F.H, përmes përfaqësueses të saj të autorizuar, më datën 26.06.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompensimin e shpërblimit jubilar në shumën prej 210.50 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se ka punuar dhe vazhdonë të punojë në SH.F.M.U. “Bekim Sylka” në Rahoveci, e sistemuar në vendin e punës si mësimdhënëse dhe atë me kontratë pune. Më tej ka shtuar se e paditura në bazë të Kontratave Kolektive ka qenë e obliguar që paditëses t’i paguajë shpërblimin jubilar për 50% të pagës bazë, duke i propozuar gjykatës që

kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë në tërësi dhe ta detyrojë të paditurën në pagesën e kompensimit për shpërblimin jubilar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 14.10.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 17.04.2017 ka qenë në fuqi deri më 21.04.2021. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv të palës së paditur, i referohemi nenit 124 par 3 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, sipas të cilit përcaktohet shprehimisht detyrimi i Ministrisë përkatëse, (si organ qendror dhe i lartë i administratës shtetërore, respektivisht autoritetet që ka deleguar kompetencën), si në vijim: “Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqim delegimit”. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditëses pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: lista e pagës për muajin Nëntor 2022; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 16/15, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses F.H.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësja ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditëses pagesa e pagës jubilarë, a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e listës së pagës për muajin Nëntor të vitit 2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësja F.H ka përvojë pune 10 vjeçare.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 16/15, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditëses F.H dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Bekim Sylka” në Rahovec.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses në lidhje me kompensimin e pagës jubilarë në shumën prej 210.50 euro. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses në lidhje me kompensimin e pagës jubilarë duke u bazuar në dispozitat e nenit 35 par.8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 që parashihet se *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë”*. Pra 50% e pagës bazë në shumën prej 421.00 euro i bie që të jetë shuma e përgjithshme prej 210.50 euro. Kjo është vërtetuar nga lista e pagës, ku vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditëses është dorëzuar më datën 26.06.2024, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit e Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Vendimin lidhur me kumatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.8.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2024:196570  
Datë: 19.11.2024  
Numri i dokumentit: 06473815

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil  
C.nr.617/2024, më datën 19.11.2024

B. profesionale  
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.